



#11 NËNTORI – DITA NDËRKOMBËTARE E JETIMËVE



11 Nëntori është Dita Ndërkombëtare e Jetimëve. E kaluam këtë ditë me fëmijët e familjes sonë të Hanna dhe Rozafës.

Mes shumë emocioneve përcollëm edhe njëherë mesazhin se çdo fëmijë meriton të ketë një familje, shumë dashuri e përkushtim dhe ritheksua edhe njëherë përpjekjet tona për de-institucionalizimin!

#MARIGLANI TANI ËSHTË I PAVARUR



Mariglani është një nga djemtë tanë të Shtëpisë-Familje 16-18 vjeç Shkodër, i cili tashmë mbushi 18 vjeç dhe sipas ligjit duhet të largohet nga institucioni.

Në kuadër të de-institucionalizimit Mariglani doli nga institucioni dhe po integrohet me sukses në shoqëri. Me mbështetjen e Kishës Ungjillore Delvinë dhe Oratorit “Don Bosko” Shkodër do të mbulohet pagesa e qirasë së shtëpisë ku do të banojë Mariglani.

Gjatë qëndrimit në institucionin tonë Mariglani ka ndjekur shkollën dhe një kurs profesional që do ta ndihmojë të integrohet në tregun e punës. Kujtojmë se Mariglani ka punuar me kontratë të rregullt pune edhe gjatë kohës së qëndrimit në institucion.

Marigleni fat të mbarë nga Shërbimi Social Shtetëror!



SHERBIMI SOCIAL

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Gjatë muajit Nëntor 2019 Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka realizuar kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për vendimmarrjen e ndihmës ekonomike në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Elbasan.

Janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin Nëntor. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark. Gjithashtu është monitoruar procesi i mbledhjes së Këshillave Bashkiakë për marrjen e vendimeve.



#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Nëntor 2019, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste VT/VMT, si edhe është menaxhuar pritja e 1 rasti në kufi.

Është mbledhur Komisioni për Personat me Aftësi të Kufizuara, ku është shqyrtuar dokumentacioni dhe është bërë një transferim.

Është mbledhur Komisioni për Fëmijët, ku pas shqyrtimit të dokumentacionit janë pranuar 2 fëmijë në IPSH dhe janë bërë 2 transferime.

Është mbledhur Komisioni për të Moshuarit, ku janë shqyrtuar 19 raste. Janë sistemuar në IPSH 6 prej tyre, janë transferuar 2 raste dhe janë refuzuar 11 prej kërkesave.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku janë shqyrtuar 74 raste, ku të gjitha kanë përfituar status.





SHERBIMI SOCIAL

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Të gjithë përfituesit e shërbimeve në institucionet tona, përveç shërbimeve sociale, marrin një paketë të plotë shërbimesh shëndetësore.

Në Qendrën Polivalente Ditore Kamëz, në bashkëpunim me Autoritetin e Shëndetit Publik dhe me Qendrën Shëndetësore Kamëz, është kryer vaksinimin kundër gripit për 30 të moshuarit që vizitojnë çdo ditë qendrën tonë.

Specialistët i dhanë të moshuarve këshillat përkatëse që do i ndihmojnë ata për të parandaluar virozat e stinës.

Stafi i Shërbimit Social Shtetëror është në krye të detyrës në të gjitha zonat e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit.

Po ofrojmë ndihmë psiko-sociale 24 orë për qytetarët e traumatizuar, argëtime për fëmijët dhe evidentim të të gjitha nevojave të qytetarëve në mënyrë që ato të adresohen sa më shpejt dhe gjendja e krijuar të kalohet sa më lehtë.

